



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:098801

Datë: 15.02.2024

Numri i dokumentit: 05333267

C.nr.875/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Diona Bajrami, në çështje juridike kontestimore të paditësit S.G. nga fshati Komuna e Prizrenit, kundër të paditurës N.G. nga fshati Komuna Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson avokatja M.Ç. nga Prizreni, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlerë e kontestit 9,580.00 euro, jashtë seance, më datë 15.02.2024, mori këtë :

A K T G J Y K I M

Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia

- I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S.G. nga fshati Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që “ *Të OBLIGOHET e paditura N.G. nga fshati Komuna Prizren, që paditësit t’ia kompensoj dëmin material në shumë prej 9,580.00 euro me kamatë ligjore duke llogaritur prej ditës së realizimit të detyrimit për mospagimin e dëmshpërblimit në afat prej 15 ditësh prej ditës pas pranimit së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim*”.

A r s y e t i m

Paditësi S.G. nga fshati Komuna e Prizrenit, pranë kësaj gjykate me dt. 24.05.2021 ka parashtruar padi, kundër të paditurës N.G. nga fshati Komuna Prizren, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlerë e kontestit 9,580.00 euro.

Me datë 12.02.2024, gjykata ka mbajtur seancën përgatitore, me ç’rast paditësi ka deklaruar se ka vendosur që këtë çështje të mos e vazhdoj tutje pasi që të paditurës ia fal dëmin për shumë arsye duke filluar nga mosha e po ashtu lidhja familjare, duke theksuar se përfundimisht heq dorë nga padia dhe kërkesëpadia, ndërsa e autorizuar e të paditurës N.G., av. M.Ç. ka deklaruar se përmes Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit numër PA.I.nr. 1918/2022 të dt. 25.04.2023 është ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren numër P.nr. 124/2021 të dt. 24.10.2022 me ç’rast e paditura është liruar nga akuza, si dhe është pajtuar me paditësin për heqjen dorë nga kërkesëpadia.

Me nenin 3 par. 1 të LPK-së është paraparë se “Palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat juridiko – civile që i kanë parashtruar gjatë procedurës”, ndërsa me par.2 të këtij neni është

paraparë se “Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë pajtim gjyqësor lidhur me kontestin e tyre”.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësit, në kuptim të nenit 149, paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) – me të cilin përcaktohet se “në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimin në bazë të heqjes dorë)” - pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë, e bazuar në nenin 3 par. 1 dhe par. 2, lidhur me nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.875/2021, datë 15.02.2024

G j y q t a r j a

Diora Bajrami

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Në kuptim të nenit 181 par. 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkakun se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.